

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GLOBAL TRENDZ” Sh.P.K

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

NENI 1

- a) Sot në Korçë në datën 03/06/2023 (dymijë e njëzet e tre) themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “GLOBAL TRENDZ” Sh.P.K , me vullnetin e lire të ortakëve , në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, formohet shoqëria me përgjegjesi të kufizuar “**GLOBAL TRENDZ**” sh.p.k , nga ortakët themelues:
- b) XHULJO DERVISHI , shtetas shqiptar , I datëlindjes 13/05/1993 , lindur në Zëmplak,Korçë, madhor me zotesi të plota për të vepruar me NID : J30513030V dhe Numer pashaporte : BJ2845698
- c) Të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe Aktin e themelimit kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre , me qëllim që të përfitojnë të ardhura që mund të vijnë nga veprimtaria e shoqërisë si dhe të përballojë humbje deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.
- d) Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë së ekonomisë së tregut të lire. Shoqëria tregtare “**GLOBAL TRENDZ**” fiton Personalitet Juridik nga dita e regjistrimit të saj pranë Zyrës së Qendrës Kombtare të Biznesit.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

NENI 2

1. Shoqëria tregtare është organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
2. Emërtimi I shoqërisë është: **“GLOBAL TRENDZ”** Sh.P.K
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet I njëjti emërtim, me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim nje shënim I cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 3

1. Shoqëria tregtare **“GLOBAL TRENDZ”** Sh.P.K e ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në fshatin Zëmlak , Maliq në adresen:

Rr.Vakefi 02470183 Nd.1 H.1 me Nr.Pasurie 182/26 ZK 3903 Zemblak,Pojan,Maliq
7014

2. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare , filial, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.
3. Shoqëria mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Njesia strukturore e shoqërisë në format e mësipërme, do të krijohet në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

KOHËZGJATJA

NENI 4

1. Shoqëria tregtare **“GLOBAL TRENDZ”** Sh. P.K do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë dhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë Krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.



OBJEKTIVI I VEPRIMTARISË

NENI 5

Objekti I shoqërise "GLOBAL TRENDZ" do të jetë: shitje ne internet online, dropshipping , Tregtia me pakicë me porosi me mail ose nëpërmjet internetit, Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 6

Shoqëria tregtare "GLOBAL TRENDZ" sh.p.k nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko - tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj. Shoqëria mund të ndryshojë emrin , selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, admistratorin, sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 7

Kapitali themeltar I shoqërisë përbehet nga : 20.000 (njetzet mije lek) I cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është kuotë me vlerë nominale : 20.000 (njetzet mije lek)

Kapitali themeltar zotërohet nga;

1. **XHULJO DERVISHI** , zotërues i 1 (një) kuote apo 100% I kapitalit të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuar nga ligji. Kapitali fillestar nuk është paguar.

NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të vecanta, të financimit për zhvillimin ekonomik tregtar.



NENI 9

1. Përberja e kapitalit të shoqërisë , fondet e krijimit të saj si dhe përdorimin e rregullimit të cdo fondi të vecantë përcaktohen nga ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të caktuara ne statut.
2. Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe ne përgjithesi cdo operacion financiar I saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqërise sipas legjislacionit në fuqi dhe ne mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

NENI 10

Shoqëria tregtare “GLOBAL TRENDZ” është pronare e pasurise së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emër të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

1. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar , asistence teknike dhe juridike do të paguhen nga fondet e shoqërisë.

NENI 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhe shqiptare. (LEK)
2. Aktiviteti financiar I shoqërisë do të mbyllet në 31 dhjetor të cdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve te vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore , inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta të hartuara nga ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël I autorizuar miratohen me Vendim të ortakëve të saj.

NENI 12

1. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirshëm të transferuar në rrugë trashëgimie.

NENI 13



1. Trasferimi I pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes, personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshime që mund të ketë pasuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

NENI 14

1. Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar, mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e ortakëve.

NENI 15

1. Zmadhimi I kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo I zvogëlimit të tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti I firmës apo nga një ekspert kontabël I miratuar.

KREU I DYTË

ORTAKËRIA

NENI 16

1. Ortakët e shoqërisë tregtare "GLOBAL TRENDZ" sh.p.k gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë , në Aktin e themelimit dhe në Statutin e shoqërisë.
Të drejtat dhe detyrat e ortakëve :

NENI 17

1. Të marrë pjese në mbledhjet e Asamblesë së ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij.
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit.
3. Të informohet mbi , përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët , e llogaritë vjetore , tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël.
4. Të përfitojë nga fitimi I shoqërisë.
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara.



KREU I TRETË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë , asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori I emeruar I ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të vecanta që ligji I jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
Administratori I shoqërisë është:

Z. XHULJO DERVISHI

- Të cilët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhënie me te tretë për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje
2. Administratori mund t'ja delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
 3. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër , I cili emërohet me vendim të Ortakëve.

ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e ortakëve është organi më I lartë vendimmarrës I shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Cdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka te drejtë :

1. Të hartojë dhe të miratojë ndryshimet në Statut.
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë.
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Të emëroje dhe të shkarkojë administratorin e shoqërisë
5. Të shpallë prishjen, likuidimin, dhe falimentimin e shoqërisë.



6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë.
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj.
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë
9. Cdo vendim tjetër që I njihet nga ligji, Akti I themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët , e me administratën publike.
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që I nevojiten asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik.
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brëndshme organizative të shoqërisë me emra perkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni I punes së Republikës së Shqipërisë.
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakeve.
5. Të testojë aftësinë e punonjesve ne administrate.
6. Të thërras Asamblenë e Ortakeve dhe të propozojë çështje që duhen analizuar.
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për cdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët.
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe ti paraqesë ato për miratim nga asambleja e Ortakëve.

NENI 22

Administratori është përgjegjes individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licencuar dhe kur kërkohët nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar të cilët jane përgjegjes per problemet e mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin , kompetencat, detyrimet, pergjegjesitë , zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin, dhe shperblimin e tij, zbatohet legjislacioni Shqipëtar në fuqi.



NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen prane kesaj shoqërie, punësimi I tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive sipas rastit, në të cilën do të percaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës pale si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja ne pune bëhet me rregjistrim në Librin e Punës së Shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e Punes së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punës, behet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punes per shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë , do të zgjidhen me mirëkuptim të paleve, të cilët për këtë qëllim mund të caktojnë nga nje përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është I mundur palet I drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor.

FORCAT MADHORE

NENI 25

1. Ortakët nuk mbajnë përgjegjesi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme.
2. Ngjarje të forcave madhore janë ato që I shpëtojnë kontrollit të ortakeve.
3. Kur ortakët ndodhen në paaftësi të plotësojnë detyrimet e tij për arsye të forcave madhore , ne bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjne cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë ne cdo kohe dhe për cfardo shkak.

Shoqëria mund të prishet para kohe:

- Me vendim të ortakëve
- Kur mbaron kohe zgjatja e shoqërisë
- Pas dy viteve të veprimtarisë me bilanc negative (humbje)
- Me vendim të gjykatës ose për arsye të tjera të parashikuara ne Statut

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi menyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose me shumë likuidatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat.



Në rastin e likujdimimit , emërtimi I shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi "Shoqëri në likujdim"

Mbasi behet njeftimi I mbylljes së likujdimimit dhe kryhen formalitetet e duhura , shoqeria rregjistrohet nga Regjistri Tregtar I Qendrës Kombëtare të Biznesit.

BAZAT LIGJORE

NENI 27

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 dt. 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

RRUAJTJA E SEKRETIT

NENI 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete qe kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informative që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.



NENI 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin tregtar në Qendrën kombëtare të Biznesit.

NENI 31

1. Ky Statut përpilohet në 5 (pesë) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore.
2. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Ortak i vetëm

XHULJO DERVISHI

